



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KF.nr.24/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ të paditësit “P...” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.Sh Avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin vendimi, objekt kontesti Rimbursim, vlerë kontesti 19,170.00 euro në seancën e shqyrtimin kryesor-publik, të mbajtur me datës 10.10.2022, në prani të autorizuarit të palës paditëse Avokat A.Sh dhe në mungesë të palës së paditur, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “P...” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.Sh Avokat në Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI vendimi nr. 382/2019 i datës 02.10.2019, i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

### A r s y e t i m

Paditësi me padinë e parashtruar në gjykatë, me datë 30.10.2019, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës ATK, duke kërkuar anulimin e vendimit nr. 382/2019 i datës 02.10.2019, dhe të obligohet e paditura të marr vendim të ligjshëm dhe të bëjë kthimin e mjeteve sipas kërkesës së paditësit, duke realizuar edhe interesin prej momentit të

parashtrimin të kërkesës dhe atë me kamatë ligjore prej 8% në vit, e deri në ditën e ekzekutimit të pagesës finale, gjithëherë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: Paditësi pretendon se janë bërë shkelje nga ana e të paditurës, sepse sipas parimit të ndëshkueshmërisë në rast se paditësit do ti dilte ndonjë periudhë ndëshkuese për vitin 2012 sipas kontrollës që ka qenë, e paditura sigurisht që do ta ndëshkonte në bazë të gjeturave. Ndërsa në rastin e Kërkesës së Rimbursimit e ka refuzuar Kërkesën për Rimbursim për vitin 2012, edhe pse kontrolla ka zgjatur për 3 (tre) muaj, dhe paditësi nuk ka pasur si ta dijë a është në debi apo kredi pranë të paditurës. Me datë 20.05.2019 kemi bërë Kërkesë për Rimbursim-Kthim për periudhat tatimore 2012, 2013, 2014, 2015 për shumën e kërkuar 83,970.00 €, e nga e cila shumë janë zbritur obligimet ndaj të paditurës prej 14,462.00 €, dhe shuma e mbetur për Rimbursim-Kthim ka qenë 69,508.00 €. Me vendimin e datës 16.07.2019 e paditura ka lejuar kthimin në shumën totale prej 53,257.85 €, mirëpo ka refuzuar kërkesën e Rimbursimit për vitin 2012, e cila vlerë ishte në shumën prej 19,170.00 €, me arsyetimin se Kërkesa për Rimbursim mund të bëhet vetëm brenda afateve prej 6 viteve, ndërsa për periudhat të cilat janë jashtë afatit prej 6 viteve nuk lejohet Rimbursimi. Nuk kam diçka tjetër për të shtuar. Andaj, kërkoj nga gjykata që të aprovohet padia si e bazuar, të anulohet vendimi i kontestuar dhe të na u kthehet shuma prej 19,170.00 € me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e Kërkesës për Rimbursim, e deri në nxjerrjen e këtij aktgjykimi shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 05.01.2021 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe konsideron se vendimi i ATK-së si palë e paditur në këtë konflikt administrativ është i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj edhe i propozon gjykatës që të refuzohet padia/ankesa e paditësit dhe të aprovohet vendimi i të paditurës si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Pala e paditur në seancën e shqyrtimit kryesor edhe pse e ftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar, andaj gjykata ka proceduar tutje në pajtim me nenin 41 të LKA-së. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik ka administruar provat dhe atë: Vendimi Nr.382/2019

i datës 02.10.2019, Raporti i Kontrollit i datës 02.05.2019, Vendimi i ATK-së i datës 16.07.2019, Njoftim i Vlerësimit për Rimbursim – Kthim të Mjeteve numër AU02700000009511, Kërkesa për Rimbursim e Brendshme e ATK-së, e datës 16.07.2019, Kërkesa për Rishqyrtim e ushtruar në ATK, 382/19 e datës 15.08.2019, Rivlerësimi për Tatim në Korporata për periudhat tatimore 2012, 2013,2014 dhe 2015, Kërkesa për Rimbursim-Kthim e datës 30.05.2019, Përgjigja në Padi e datës 05.01.2021, Tabela nga ATK e titulluar Të Gjitha Vlerësimet për Periudhën 2012.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nuk është kontestues fakti se paditësi me datë 20.05.2019, ka paraqitur kërkesë pranë ATK-së për kthimin e debi-kredive të tatimpaguesit në shumën prej 83,970.00 euro, për periudhat 2012, 2013, 2014 dhe 2015 për llojin e tatimit në të ardhura të korporatave e për të cilën kërkesë e paditura me vendimin e datës 16.07.2019, ka aprovuar shumën prej 64,800.00 euro nga e cila shumë është ndalë obligimi për ATK-ë prej 11,542.15 euro dhe shuma e mbetur prej 53,257.85 euro është transferuar në xhirollogarinë e këtui paditësit. Nuk janë kontestuese as fakti se këtu e paditura nuk ka aprovuar shumën prej 19.170.00 euro që i referohet rimbursimit/kthimit të TAK-ë për periudhën tatimore 2012, me arsyetimin se kërkesa është paraqitura jashtë afatit 6 vjeçar. Këtu paditësi ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë të paditurës e për të cilën kërkesë këtu e paditura me datë 02.10.2019, ka sjell vendimin nr. 382/19, si akt administrativ përfundimtar i nxjerr në shkallë të dytë pranë të paditurës e ndaj të cilit akt këtu paditësi ka iniciuar këtë konflikt administrativ me padinë e datës 30.10.2019.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Departamenti i Ankesave-ATK, e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë “P...” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.Sh Avokat në Prishtinë, këtu paditësit,

E paditura refuzimin e pjesshëm të kërkesës për kthimin e debi-kredive dhe atë vetëm për periudhën tatimore 2012, që i referohet llojit të tatimit TAK-ë, e ka bërë për shkak të kalimit të afatit ligjor prej 6 vitesh, nga data kur janë bërë pagesat e tatimit ose kur deklaratat e tilla janë detyruese për t'u dorëzuar në ATK-ë 02.04.2013, e deri në paraqitjen e kërkesës për kthimin e debi-kredive 20.05.2019, duke u thirrur në dispozitën e nenit 30, par 3 të ligjit 03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe nenit 41, par 11, i UA 15/2010 për zbatimin e ligjit 03/L-222.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadsisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Pretendimi i paditësi se nuk është vonuar në kërkesën për kthimin e mjeteve për periudhën tatimore 2012, ngase nuk e ka ditur nëse është në debi apo në kredi për derisa nuk e ka pranuar raportin e kontrollit të datës 02.05.2019, për gjykatën është i paqëndrueshëm sepse kërkesa për rimbursim dhe apo kthim të çfarëdo kredie është kategori ligjore dhe e cila është e lidhur strikt me afat ashtu siç parashihet në nenin 30, par 3, të ligjit 03/L-222 ku thuhet se : *“Kërkesa për kreditim ose rimbursimi për një pagesë të tepërt të çfarëdo lloji të tatimit mund të dorëzohet brenda gjashtë (6) vitesh nga data kur është paguar tatimi. Procedura për aplikim të rimbursimit të tatimit do të rregullohet me akt nënligjor“*, dhe se si e tillë kjo kërkesë askund në ligj nuk lidhet me të gjeturat eventuale nga një raport i kontrollit nga e paditura, për më tepër raporti i kontrollit i datës 02.05.2019 nuk është hapur mbi bazën e kërkesës për rimbursim/kthim të mjeteve por bazuar në humbjet e vazhdueshme, (shi faqen 2 të raportit) andaj nga interpretimi i drejtë i dispozitës ligjore si më lartë në mënyrë shprehimore përcaktohet obligimi i vet tatimpaguesit që të paraqes

kërkesë për kreditim për një pagesë të tepërt të çfarëdo lloji të tatimit, dhe e cila kërkesë konform paragrafit 3, të këtij neni, është e lidhur me afatin ligjor prej 6, vitesh.

Gjykata nga kërkesa e datës 20.05.2019, drejtuar ATK-së, për kthimin e debi-kredive të tatimpaguesit këtu paditësit, konstaton se e njëjta i referohet periudhave tatimore 2012, 2013, 2014 dhe 2015, ku është bërë pagesë më e tepërt dhe atë për llojin e tatimit TAK-ë, tutje nga formulari MFA2H10068150631 “Rivlerësimi për tatimin në korporata” për periudhën tatimore kontestuese 2012, Gjykata ka gjetur se e njëjta si datë kur duhet bërë deklarimi pranë ATK-së dhe datë kur duhet të bëhet pagesa ka qenë 02.04.2013, dhe meqë në rastin konkret kemi të bëjmë me tatimin në të ardhura të korporatave, atëherë kjo çështje si e tillë është rregulluar shprehimisht edhe me nenin 41, par 11 të UA 15/2010 për zbatimin e ligjit 03/L-222, ku decidivisht thuhet se : *“Kërkesa për rimbursim mund të dorëzohet në çdo kohë pas afatit për dorëzimin e deklaratës së aplikueshme deri në 6 vjet nga data kur është paguar tatimi. Për qëllime të përcaktimit të datës së pagesës së tatimit, pagesat paradhënie të Tatimit në të Ardhura të Korporatave (TAK) apo Tatimi në të Ardhura Personale (TAP), do të konsiderohen të jenë paguar në datën kur deklaratat e tilla janë detyruese për t’u dorëzuar në ATK“*, dhe nga interpretimi i drejtë i kësaj dispozite gjykata vlerëson se për qëllime të përcaktimit të datës së pagesës së tatimit do të konsiderohen të jenë paguar në datën 02.04.2013, atëherë kur deklaratat e tilla kanë qenë detyruese për t’u dorëzuar në ATK-ë sipas formularit MFA2H10068150631, dhe si ditë e fundit për të paraqitur kërkesë për rimbursim për periudhën tatimore 2012, sipas formularit si më lartë ka qenë data 01.04.2019, derisa në rastin konkret kërkesa është bërë me datë 20.05.2019 dhe atë pas kalimit të afatit ligjor prej 6 viteve.

Gjykata vlerëson se nga gjendja faktike e vërtetuar si më lartë dhe bazuar në dispoziten e nenit 30, par 1 dhe par 3, të Ligjit nr. 03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe nenit 41, par 11, të UA 15/2010, për zbatimin e ligjit 03/L-222, e paditura ka vepruar drejtë kur e ka refuzuar kërkesën e paditësit për kthimin e debi-kredive të tatimpaguesit për periudhën tatimore 2012, për TAK-ë, pasi që e njëjta është bërë pas kalimit të afatit ligjor prej 6, vitesh, e me të cilin afat ligjor është e lidhur edhe kërkesa e paditësit por edhe veprimi i të paditurës, në këtë rast të Administratës Tatimore të Kosovës, duke u bazuar

kjo e fundit vetëm në kërkesën e lejueshme për kreditim ose rimbursim, siç kërkohet me par 4, të nenit si më lartë.

Ligjit nr. 03/L-222, PËR ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, Neni 30, Kreditimet dhe rimbursimet, paragrafi 1. *“Çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor, me kërkesën e tatimpaguesit do të kreditohet ndaj detyrimit aktual të tatimpaguesit për çdo detyrim tjetër tatimor dhe kontribute pensionale. ATK-ja do t’i dorëzojë tatimpaguesit njoftim më shkrim aty ku pagesa e tepërt është përdorur për mbulimin e një detyrimit tjetër, duke e informuar tatimpaguesin për shumën e kreditimit të aplikuar, tatimin dhe periudhën tatimore”*, paragrafi 2. *“Në rastin kur tatimpaguesi nuk ka detyrime tjera ndaj ATK-së, ose kur ka mbetur një shumë tepërcë nga tatimi i mbi paguar, pasi tepërcia e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni është përdorur për të shlyer detyrimet e tjera tatimore, tatimpaguesi ka të drejtë t’i kërkojë ATK-së rimbursimin e shumës së mbetur”*, paragrafi 3. *“Kërkesa për kreditim ose rimbursim për një pagesë të tepërt të çfarëdo lloji të tatimit mund të dorëzohet brenda gjashtë (6) vitesh nga data kur është paguar tatimi. Procedura për aplikim të rimbursimit të tatimit do të rregullohet me akt nënligjor”*, paragrafi 4. *“ATK-ja do të veprojë lidhur me kërkesën e lejueshme për rimbursim brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data kur ka pranuar kërkesën nga tatimpaguesi, duke siguruar që detajet e shumës për rimbursim i janë përcjellë me kohë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ose me rastin e kontributeve pensionale, në Trustin e Kursimeve për Pensione të Kosovës”*.

Neni 41, par 11, I UA 15/2010 për zbatimin e ligjit 03/L-222, ka përcaktuar se : *“Kërkesa për rimbursim mund të dorëzohet në çdo kohë pas afatit për dorëzimin e deklaratës së aplikueshme deri në 6 vjet nga data kur është paguar tatimi. Për qëllime të përcaktimit të datës së pagesës së tatimit, pagesat paradhënie të Tatimit në të Ardhura të Korporatave (TAK) apo Tatimi në të Ardhura Personale (TAP), do të konsiderohen të jenë paguar në datën kur deklaratat e tilla janë detyruese për t’u dorëzuar në ATK”*.

Neni 43, par 1. i LKA-së, *“Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”*, andaj paditësi në këtë konflikt administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e

tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsytimit ligjor dhe faktik të ankesës, ashtu siç parashihet me nenin Neni 81 F, paragrafi 1 dhe 81 E, paragrafi 4, pika 4 dh 5 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 .

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thënie e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në pajtim me nenin 64 të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, pasi që sipas këtij neni në konflikt administrativ secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë/Departamenti Fiskal

KF.nr.24/2022, datë 10.10.2022

Bashkëpunëtori Profesional  
Visar Gashi

Gj y q t a r i,  
Fisnik NULI

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.